



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

FTESE PËR NEGOCIATA

Mbështetur në VKM nr. 1195, datë 05.08.2008, “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve apo të reklamave për trasmetim nga operatorët radio televiziv ose botim në median e shkruar dhe për kontratat për kohë transmetimi nga organet e administratës shtetërore”, në VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 205, datë 30.3.2026 “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2026”,

Objekti i programit/spotit/reklamës: Informimi mediatik i publikut lidhur me masat e mbështetjes direkte dhe mbështetjes për investime, për vitin 2026.

Nevoja për kryerjen e reklamave: Me anë të kësaj fushate komunikimi do të bëhet i mundur realizimi i objektit: “Për informimin e publikut për masat e mbështetjes direkte dhe mbështetjes për investime, për vitin 2026”, dhe marrja e informacionit në të gjithë territorin e vendit.

Të zhvillohet procedura e blerjes, zhvillimit dhe prodhimit të spotiteve/reklamave: “Për informimin mediatik të publikut të gjerë, lidhur me implementimin e masave të mbështetjes direkte dhe mbështetjes për investime, për vitin 2026”, me fond limit 15,570,987.50 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Ideimi i spoteve/video informuese të kryhet nga organet e specializuara në këtë fushë dhe transmetimi të kryhet nga media e shkruar/online, publikim në 4 gazeta, 1 (një) Spot i përgjithshëm për Skemën Kombëtare 2026 për transmetim në radio, si dhe reklamim/promovim në rrjetet sociale Facebook dhe Instagram, Video Graphic 28 (13 Video promovuese për fushatën e aplikimeve dhe 15 Video histori suksesi), 13 Inforgrafikë informuese, Fletëpalosje me QR Code, Printim posterash, printim Roll Up, Organizimi i takimeve informuese në 12 qarqe.

Objekti i programit të spoteve/reklamave për sektorët që do të mbështeten, nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural nëpërmjet pagesave direkte në bujqësi si dhe mbështetje për investimeve është:

- rritja e konkurrueshmërisë së prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, duke ulur kostot nëpërmjet pagesave direkte për sipërfaqe të kultivuar dhe për kafshë të matrikulluara;
- kontrolli biologjik i dëmtuesve të perimeve në serra, certifikimin e produkteve bujqësore dhe të fermave organike;

- mbështetja me grante për investime në ferma, agropërpunim, akuakulturë dhe agroturizëm.

TEKSTI DHE KONTENTI

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall thirrjen për aplikime nga fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2026.

Bazuar në VKM nr. 205, datë 30.3.2026 “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2026”, sektorët që do të mbështeten dhe masa e financimit për vitin 2026, janë si më poshtë vijon:

Masat e mbështetjes dhe masa e financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë, si më poshtë vijon:

- Pagesa direkte në bujqësi dhe blegtori është, si më poshtë vijon:

a) Në vlerën deri në 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë/krerë, për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/aplikant, me jo më pak se 5 (pesë) krerë lopë dhe/ose mëshqerra. Për pjesën mbi 50 (pesëdhjetë) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor (në vijim SHBB)”;

b) Në vlerën deri në 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë/krerë për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/aplikant, me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) krerë dele dhen/ose dhi. Për pjesën mbi 300 (treqind) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “SHBB”;

c) Për mbarështimin e bletarisë, në vlerën deri në 2 000 (dy mijë) lekë për zgjua, për fermer/aplikant, me jo më pak se 25 (njëzet e pesë) zgjoje. Për pjesën mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë) zgjoje, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “SHBB”;

ç) Për dosa dhe/ose paradosa të matrikulluara, në vlerën deri në 7 000 (shtatë mijë) lekë/krerëdosa/paradosë, për fermer/aplikant, me jo më pak se 5 (pesë) krerë dosa dhe/ose paradosa. Për pjesën mbi 100 (njëqind) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “SHBB”;

d) Për kontrollin biologjik të dëmtuesve të perimeve (domate, specat, tranguj) në serra dhe/ose luleshtrydheve në tunele plastike, masa e përfitimit është 70% e vlerës totale të faturave tatimore, për blerjen e materialeve biologjike, përfshirë insektet e dobishme, por jo më shumë se 40 000 (dyzet mijë) lekë për dynym, në rastin e dy mbjelljeve në vit. Për fermerët individualë, që aplikojnë për mbështetje për kontrollin biologjik, sipërfaqjeminimale e kultivuar është 1 (një) dynym, ndërsa për aplikantët me status “SHBB”, sipërfaqjeminimale është 1 (një) ha, për secilën nga mbjelljet;

dh) Për fermat organike për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në vitin e dytë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, në vitin e tretë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë për fermë të certifikuar;

e) Për implementimin dhe certifikimin global GAP, përfshirë mbulimin e kostove të analizave të produkteve në perime, fruta, rrush, ullinj, agrume dhe kultura të tjera bujqësore të certifikueshme, në masën 50% të vlerës totale të faturës tatimore, por jo më shumë se:

i. 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha për certifikim individual;

ii. 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 3 (tre) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 10 (dhjetë) ha në fushë të hapur, për certifikim në grup, me minimumi 10 (dhjetë) fermerë të përfshirë; iii. 700 000 (shtatëqind mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 30 (tridhjetë) ha në fushë të hapur, për certifikim në grup, me minimumi 20 (njëzet) fermerë të përfshirë;

ë) në vlerën deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë për ha, për sipërfaqe të mbjellë me kulturabujqësore. Sipërfaqja totale, për të cilën aplikohet, duhet të jetë jo më pak se 3 (tre) ha. Për sipërfaqe mbi 10 (dhjetë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “SHBB”;

f) për mbështetje për aktivitetin ripopullim peshkimi për ujërat e brendshme për blerje rase të peshku, masa e përfitimit është në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë për subjekt.

- Mbështetje për investime për:

a) masat e përcaktuara në shkronjat: “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë” dhe “f”, të nën-pikës 2.4, të vendimit nr. 150, datë 6.3.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2025”, të ndryshuar;

b) fermerë të rinj, për investime në ferma bujqësore dhe blegtorale, masa e përfitimit është në 70% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë;

c) ndërtimin/rikonstruksionin e staneve dhe/ose pajisjeve për përmirësimin e kushteve, masa e përfitimit është në 70% të vlerës së faturave tatimore, por jo më shumë se 3 000 000 (tre milionë) lekë për subjekt.;

ç) pajisje, makineri dhe mjete bujqësore për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në ferma bujqësore dhe blegtorale, masa e përfitimit është në 50% të vlerës së faturave tatimore, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt dhe jo më pak se 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për subjekt. 3. Fondi total për mbështetjen për investime, të përcaktuara në shkronjat: “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të nën-pikës 2.2, është në vlerën deri në 2 500 000 000 (dy miliardë e pesëqind milionë) lekë. 4. Nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2026, përdoret shumadheri në:

a) 159 954 159 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë milionë e nëntëqind e katër mijë njëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë, për pagesën e vlerës së palikuiduar për kontratat, për të cilat nuk është

autorizuar pagesa finale në masat e mbështetjes për investime nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, në zbatim të pikave 2.3 dhe 3/2, të vendimit nr. 130, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2024”, të ndryshuar; b) 9 662 269 (nëntë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë enëntë) lekë, për pagesën e vlerës së palikuiduar, për subjektet përfituese, në zbatim të vendimit nr. 150, datë 6.3.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2025”, të ndryshuar.

Informacioni i nevojshëm për mënyrën e aplikimit, kriteret e përfitimit dhe procedimit deri në përfitimin e mbështetjes financiare gjendet pranë Agropikave, pranë Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Zyrave Qendrore të AZHBR si dhe në faqen e internetit: www.azhbr.gov.al dhe www.mbzhr.gov.al.

Procedura e blerjes, zhvillimit dhe prodhimit të spoteve/reklamave: “Për informimin e publikut për masat e mbështetjes direkte dhe mbështetjes për investime, për vitin 2026”, do të zhvillohet sipas specifikimeve teknike të më poshtme:

1. Publikimi në median e shkruar/online

Publikimi i Skemës Kombëtare të Mbështetjes për vitin 2026, në minimum 4 gazeta të përditshme (të printuara ose online), për një kohëzgjatje prej 10 ditësh.

2. Reklamim në radio

- Prodhimi i një spoti radiofonik
- Transmetimi i spotit në minimum 4 radio (1 kombëtare dhe 3 lokale), duke mbuluar të gjithë territorin e vendit, me fokus të veçantë në zonat rurale
- Frekuenca: jo më pak se 4 herë në ditë
- Kohëzgjatja: jo më pak se 30 sekonda

3. Reklamim në rrjete sociale

- Reklamim/promovim në rrjetet sociale Facebook dhe Instagram
- Audiencia e synuar: 100,000 përdorues në ditë
- Frekuenca e shfaqjes: 2 herë në ditë
- Kohëzgjatja e fushatës: 10 ditë

4. Video promovuese për Skemën Kombëtare 2026 (13 video)

- 1 video hapëse e përgjithshme për hapjen e aplikimeve

- 9 video (nga 1 për secilën masë direkte të mbështetjes)
- 3 video (nga 1 për secilën masë investimi)

Kërkesat:

- Gjatësia: jo më pak se 30 sekonda secila
- Përmbajtja: imazhe, titra shpjegues, sfond muzikor, logo e AZHBR dhe MBZHR, si dhe adresa e faqes zyrtare të AZHBR
- Format: MP4, HD (horizontal ose vertikal), për rrjetet sociale
- Dorëzimi: në format digjital (CD ose USB)
- Afati: maksimumi 5 ditë pune nga kërkesa me shkrim/email e AZHBR.

5. Infografikë informues (13 infografikë)

- 1 infografik i përgjithshëm për hapjen e thirrjes (me afatin e aplikimit dhe numrin e gjelbër)
- 9 infografikë për masat direkte (nga një për secilën masë)
- 3 infografikë për masat e investimeve (nga një për secilën masë)

Kërkesat:

- Të përmbajnë imazhe sipas masave, logo AZHBR dhe MBZHR, si dhe adresën e internetit
- Format: HD
- Afati: maksimumi 5 ditë pune nga kërkesa me shkrim/email e AZHBR

6. Video histori sukcesi (15 video)

- Për përdorim në rrjete sociale
- Gjatësia: jo më pak se 30 sekonda
- Me sfond muzikor
- Të përmbajnë imazhe të fermerëve përfitues dhe impaktin e mbështetjes në fermë
- Të përfaqësojnë logot e AZHBR dhe MBZHR

Kërkesat:

- Format: MP4, HD (horizontal/vertikal)
- Dorëzimi: CD ose USB
- Afati: maksimumi 5 ditë nga kërkesa e AZHBR

Shërbimet dhe komponentët

7. Fletëpalosje me QR code (5000 copë)

- Përmasat: 21 x 29,7 cm (format A4)
- 4 faqe

- Printim me 4 ngjyra
- Përmbajtja: logo AZHBR dhe MBZHR, numri i gjelbër, adresa e internetit
- Letër: 115 gr

8. Printim posterash (50 copë)

- 1 faqe
- 4 ngjyra
- Format A3
- Letër: 115 gr

Afati: maksimumi 5 ditë pune nga kërkesa me shkrim/email e AZHBR.

9. Printim roll-up (8 copë)

- 1 dizajn
- Përmasat: 100 x 200 cm
- Material: baner + mekanizëm mbajtës

10. Organizimi i 20 takimeve informuese në qarqe/rrethe të vendit;

- Takimet të zhvillohen në 12 qarqet/rrethe: Tiranë, Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier, Berat, Vlorë, Elbasan, Korçë, Dibër, Gjirokastër dhe Kukës;

Kërkesat:

- Ambient outdoor ose indoor
- Kapacitet: 70–100 persona (me karrige)
- Pajisje: sistem audio, projektor, pajisje ndihmëse, 2 mikrofonë për diskutim
- Asistencë teknike gjatë aktivitetit

Termet e referencës

Fletëpalosje me QR code

- Operatori realizon tekstin dhe layout-in grafik
- Përmbajtja: tekst dhe logot përkatëse
- Duhet të përmbajë logot e AZHBR dhe MBZHR

Afati: maksimumi 5 ditë pune nga kërkesa me shkrim/email e AZHBR.

Roll-up

- Operatori ekonomik merr përsipër hartimin e konceptit, përgatitjen e tekstit dhe realizimin e layout-it grafik.

- Roll-up-et do të përmbajnë 1 dizajn.
- Dizajni duhet të ketë përmbajtje informuese mbi thirrjen për aplikim, masat mbështetëse, imazhe ilustruese të fermerëve, blegtorëve, bletarëve etj., sipas natyrës së masave, afatet e aplikimit, logot zyrtare të AZHBR dhe MBZHR, adresën e faqes zyrtare dhe numrin e gjelbër.
- Duhet të përmbajë logot përkatëse

Afati: maksimumi 5 ditë pune nga kërkesa me shkrim/email e AZHBR.

Organizimi i aktiviteteve

- Aktivitetet zhvillohen gjatë muajve Prill – Maj 2026
- Operatori ekonomik merr përsipër transportin e materialeve (karrige, roll-up, etj.)
- Operatori ekonomik organizon aktivitetet sipas specifikimeve teknike.

Monitorimi i procedurës së ndjekur nga kompania e specializuar që ushtron këtë aktivitet dhe monitorimin e gjithë praktikës.

Të paraqitet një projekt ide-skenar për realizimin e shërbimit në CD ose hardcopy.

Fondi limit është 15,570,987.50 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

➤ **Dokumente ligjore që duhen paraqitur, si kriter kualifikues:**

- Ekstrakt historik i QKR, që vërteton se Operatori Ekonomik ushtron aktivitet ekonomik tregtar që përputhet me objektin e procedurës dhe është aktiv;
- Vërtetim që ka paguar detyrimet tatimore koherente;
- Vërtetim të xhiros vjetore të realizuar gjatë 3 viteve 2023-2024-2025;
- Vërtetim për numrin e punonjësve për periudhën Janar 2026-Mars 2026;
- Vetëdeklarim mbi gjendjen gjyqësore, ku shprehet se, operatori ekonomik nuk ka ndjekje penale, si dhe nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata, që lidhet me aktivitetin profesional.

➤ **Dokumentacioni financiar, si kriter kualifikues**

- Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë bankare së bashku me nr. IBAN;
- Kontratë të ngjajshme të realizuar gjatë tre viteve të fundit me shtetin (referencë ose kontratë) dhe/ose me subjekte private (faturat përkatëse dhe/ose kontrata);
- Sigurimin e ofertës në masën 2% të vlerës së fondit limit;
- Deklaratën që subjekti nuk është në konflikt interesi;
- Deklaratën që i përmbush specifikimet dhe termat e referencës;
- Deklaratë konfidencialiteti;

- Formularin e ofertës;
- Media plan paraprak për shpërndarjen/transmetim;
- Deklaratë nga operatori ekonomik që transmetimi i reklamës do të jepet nga organet e medias, të cilat janë aktive dhe të licensuara sipas legjislacionit në fuqi.

Dokumentacioni të jetë origjinal ose kopje e noterizuar dhe duhet të jetë lëshuar brenda tre muajve nga data e zhvillimit të procedurës.

Kriteret e vlerësimit të subjekteve janë :

Vlerësohet me 35 (tridhjetë e pesë) pikë -> Projekt-ideja e realizimit të spoteve/reklamave, e cila përmban idejimi/krijimi;

Projekt ideja do të vlerësohet nga Komisioni, në varësi të projekt idesë më të mirë të paraqitur.

Vlerësohet me 30 (tridhjetë) pikë -> Koha radiofonike e blerë për transmetimin e Spoteve/reklamave (sipas logjikës së formulës më poshtë).

KR - Koha radiofonike
 KRM - Koha radiofonike me e madhe
 KRV - Koha Radiofonike e që vlerësohet

$$KR = \frac{30 * KRV}{KRM}$$

Vlerësohet me 35 (tridhjetë e pesë) pikë-> oferta më e ulët ekonomike në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta (sipas logjikës së formulës më poshtë).

OE- Oferta ekonomike
 OU- Oferta më e ulët
 OV- Oferta që vlerësohet

$$OE = \frac{35 * OU}{OV}$$

Vlerësimi përfundimtar = pikët për projekt idenë + pikët për kohën televizive + pikët për ofertën ekonomike.

Oferta duhet të jetë origjinale si dhe dokumentacioni i kërkuar më sipër duhet të jenë të futur në zarf jo transparent, të mbyllur, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën tuaj.

Mbi zarf të jetë shënuar “**Ftesë për Negociatë**”. Përzgjedhja e ofertave do të realizohet sipas VKM nr. 1195, datë 5.8.2008, dhe kriterve të përshkruara dhe metodologjisë me sistemin e pikëve.

Monitorimi i publicitetit do të kryhet sipas përcaktimeve që do të vendosen në kontratën e shërbimit ndërmejt palëve.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë AZHBR deri në datën **28.04.2026, ora 15:00.**

Komisioni pret konfirmimin nga operatorët ekonomik për vazhdimësinë e negociatave, brenda afatit të fundit të paraqitur në ftesën për negociata.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë jashtë këtij afati dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Pas analizimit të ofertave, të paraqitura nga organet e masmedias/agjencitë e specializuara, komisioni përzgjedh, në bazë të pikëve, organet e masmedias/agjencitë e specializuara, duke u bazuar në kushtet e veçanta, të përcaktuara.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ardita Kuçi